



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 31

Datë: 17. 06. 2017, ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi. Përkthyes: Vera Dula

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së
 2. Raport nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)
 3. Të ndryshme.
-

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Përsëritje të gjithëve! E hapim mbledhjen e 31 të KQZ-së. Sa i përket rendit të ditës, kemi vetëm raportin nga qendra e numërimit dhe, të ndryshme! Kush është për këtë rend dite? Faleminderit!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Valdete Daka: Vazhdojmë... Burim, urdhëro...!

2. Raport nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)

Burim Ahmetaj: Faleminderit, kryetare! Të nderuar anëtarë të KQZ-së, QNR në bazë të dinamikës dhe punës ka përfunduar numërimin e vendvotimeve të cilat është dashur të rinumërohen nga karantina. Rinumërimi ka përfunduar dhe janë rinumëruar të gjitha ato vendvotime të cilat KQZ

ka marrë vendim të rinumërohen. Pra, të gjitha këto raste kanë qenë si shkak i parregullsive të cilat janë evidentuar gjatë procesit të pranimit. Nuk kanë mundur të procedohen si të rregullta, është bërë rinumërimi i tyre. QNR i ka publikuar edhe rezultatet e tyre në përputhje me procedurat e numërimit dhe votimit sikurse publikohen rezultatet për këto vendvotime në vendvotim po ashtu edhe qendra e numërimit i ka publiku në objektin e qendrës së numërimit rezultatet e rinumëruara tani e kemi bërë që skanimin e formularëve të rezultateve dhe tash pritët të rezultatet e reja pra të rinumëruara të publikohen në ueb-faqe pra duhet të jetë një follder i veçantë që i referohet këtyre 30 vendvotime që janë rinumërua kjo është sa i përket pjesës së rinumërimit dhe kompletimit të këtij procesi pra gjithmonë duhet ju referuar vendvotimeve apo procesit të pranimit sot duhet të jetë e pastruar dhe pjesa e kantinës të cilat KQZ ka marrë vendim që të procesohen si të rregullta kështu që do të duhen të procesohen me të gjitha këto materiale në mënyrë që të kemi procesin të kompletuar.

Në hapësirën e futjes së të dhënave, tha z. Ahmetaj, jemi në procesin e futjes e të dhënave të formularëve të rezultateve për subjekte dhe kandidat. Po ashtu e kemi afër kompletimin e procesit të skanimit të listave përfundimtare të votuesve, si dhe jemi në proces të regjistrimit të votuesve me kusht. Regjistrimi i votuesve me kusht në bazën e të dhënave bëhet me qëllim që të krahasohet me votuesit të cilët kanë votuar në mënyrë të rregullt dhe vota me kusht pasi të identifikohet ajo votë me kusht të hiqet. Nga procesimi i formularëve të rezultateve, një numër i vendvotimeve nuk kanë mundur të procesohen si të rregullta për shkak të mospërputhjeve, dhe ato vendvotime kanë përfunduar në auditim ku qendra e numërimit dhe e rezultateve ka bërë hetimet dhe auditimet në vendvotimet të cilat që thash nuk kanë mundur të procesohen si të rregullta. Arsyet se pse kanë shkuar këto vendvotime në auditim nga rastet më të shpeshta janë kur subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, kandidati ka më shumë vota se sa subjekti dhe arsyeja tjetër që kanë përfunduar në auditim është kur kandidatët kanë më shumë vota se subjekti. Pra, shumica e vendvotimeve ka të bëjë me formularët e rezultateve të kandidatëve. Nga vendvotimet që i keni sjellë këtu vetëm 3 vendvotime kanë probleme me mospërputhje me formularë në FPR-ë ose për formularët të rezultateve për subjektin, ndërsa pjesa tjetër janë për formularët për rezultatet e kandidatëve. Raporti nuk është i plot sepse jemi akoma në proces, përpara jush në tabelën në Excel i keni 115 vendvotime të cilat janë të kategorizuara në 4 kategori. Besoj që ndoshta jeni duke shikuar në tabelën në Excel. Kategoria e parë është kur ka mospërputhje të votave të kandidatëve, pra vetëm te një subjekt. Pra, të gjitha këto vendvotime nuk kanë mundur të procesohen si të rregullta, është bërë hetimi, është bërë auditimi dhe është gjetur, pra nga gjetjet në auditim kemi gjetur se të një subjekt ka mospërputhje pra ka tejkallim të votave të kandidatëve.

Kategoria e dytë, vuri në dukje z. Ahmetaj, është mospërputhja e votave të kandidatëve të dy subjekteve. Gjatë auditimit, është gjetur se tek dy subjektet ekzistojnë prapë probleme me votat e kandidatëve. I keni të listuara në dokumentin në Excel ku është kategoria e dytë. Dhe, numri është më i vogël pra ku në bazë të gjetjeve vijnë dy subjekte që kanë probleme me mospërputhje. Kategoria e tretë është te mospërputhja e votave të kandidatëve kur janë gjetur tri subjekte. Dhe kategoria e katërt kur janë vetëm tri formular të rezultateve është mospërputhje në formular të rezultateve. A ka nevojë me ju hy rasteve një nga një apo sipas kategorive me i përmend? Sipas kategorive. Kategoria e katërt është mospërputhje në formular të rezultateve, procedurat e qendrës së numërimit dhe rezultateve lejojnë ku ka ngatërrim të rubrikave të përmirësojmë. Mirëpo në këto raste nuk kemi mundur të gjejmë as qendra e numërimit dhe rezultatit nuk ka mundur ti korrigjoj këto mospërputhje sepse ka pasur mospërputhje të mëdha. Edhe në faqen e fundit janë edhe të arsyetuara se çfarë mospërputhjesh ka në këto FPR-ë dhe rekomandimi është sjellë që këto ndoshta pas rinumërimit të mund të korrigjohen. Pra, nuk kemi mundur në asnjë mënyrë me gjetur mënyrën se si rregullohen edhe nëse ka pasur rubrika të ngatërruara, sepse kemi fletëvotime më shumë se sa është dashur të jenë. I keni të specifikuar edhe në raport pra në faqen e fundit janë tri FPR-ë. Një është nga Prizreni, një është nga Vitia ku në faqe të formularit të rezultateve të kandidatëve mungon

një faqe, dhe në Vushtrri e keni po ashtu një vendvotim ku votat e vlefshme si dhe vendvotimet e paplotësuara brenda kutisë edhe ato të pavlershme e tejkalojnë numrin e fletëvotimeve brenda kutisë.

Pra, këto janë pak a shumë problemet e përgjithshme tha z. Ahmetaj i cili pastaj, bëri një përshkrim të kategorive. Ai tha se, kemi ndoshta edhe vetëm një votë të vetme që është më tepër sesa që është e lejuar. Pra, kjo ka të bëjë me rastet kur kandidati ka me shumë vota sesa subjekti, apo edhe kandidatët kanë më shumë vota se sa subjektet. I kemi te listuara mbas të gjeturave te tejkalmi i votave, nëse shikoni në rubrikë, i kemi të listuara prej votës, një votë që është ma tepër, deri te dallimi ku është edhe 249 vota. Mirëpo, këto janë ndoshta edhe në raste kur subjekti nuk ka vota, dhe kandidatët kanë. Pra, sistemi i identifikon këto mospërputhje dhe janë të pasqyrueme tek rasti i parë. Rasti i dytë, është kur kemi gjetur mospërputhje tek dy subjekte edhe pse ndoshta numri i votave apo dalim është shumë i vogël, mirëpo ka mos përputhje te dy subjektet. Dhe rasti i tretë, është te tri subjekte. Nëse doni me detaje rreth raportit në Excel, mundë që të ju jap detaje, mirëpo janë për secilin vendvotim...! Ndoshta KQZ-ja ka ndonjë pyetje apo ndonjë shpjegim që duhet prej qendrës së numërimit për vendvotime të caktuara...

Valdete Daka: Faleminderit Burim! Të falënderoj për këtë raport gjithëpërfshirës! Në qoftë se anëtarët kanë ndonjë pyetje...?

Betim Gjoshi: Faleminderit, Burim për raportin në të gjitha fushat që na ke sjellë! Unë kam disa komente për sa i përket kësaj pjesës së rekomandimit edhe të raportit për rinumërim. Pastaj i kam edhe disa pyetje kur do të filloj procesi i numërimit të votave me kusht edhe votave nga diaspora. Unë mendoj që edhe nga raportet e juaja që keni sjell, rastet janë shumë më të vogla edhe më pak probleme se në secilën parë zgjedhje. Por ne si Komision Qendror Zgjedhor duhet me garantuar edhe publikun edhe kandidatët edhe subjektet që janë pjesëmarrëse që do të mundohemi që çdo votë të qytetarëve me procedurat që kemi ne ta dërgojmë në vendin e duhur pra, ta implementojmë vullnetin e votuesve, edhe mendoj që në këtë rast edhe këtë e detekton puna juaj, e ka detektuar në çdo vend ku ka mundur të ketë probleme edhe pse mund të jenë minimale d.m.th. ndoshta edhe gabime njerëzore që ne do ti rinumërojmë. Edhe për mua, edhe pse nuk është numër i madh krahasuar me zgjedhjet e kaluara vazhdojmë të kemi probleme d.m.th. sa i përket vota me kandidat. Ndoshta publikun ia vlen me e sqaruar pak më shumë në këtë çështje ku partia ka kandidat, nuk kanë këto raste janë kur janë vendosur në formular të rezultateve gabimisht votat e një partie tjetër që ka pasur numër më të përafërt sidomos prej fletës punës prej asaj që kemi parë prej praktikës, se nuk është që kanë mund të kenë kandidatë pa pasur subjekti. E di që kanë punë, kanë ngarkesë këshillat e vendvotimit në orare të gjata. Nuk i përjashtoj edhe mundësit e qëllimshme por, ne duhet të rinumërojmë çdo kuti e cila ofron mospërputhje dhe të vazhdojmë me këtë dinamik. Edhe në fund kishte qenë mirë me na treguar pak a shumë, se po e shohim që ka një progres të mirë d.m.th. mbi 70% të punës është përfunduar në Qendra e Numërimit të Rezultateve edhe ku do të vazhdojmë me votat me kusht. Kuptojmë që këto në bazë të orarit që na ke dhënë për dy ditë përfundohen këto rinumërimet që sot ke sjell 115 vendvotimeve. A po mendoni, a keni ndonjë agjendë kur do të startojmë me votat me kusht edhe me votat e diasporës? Edhe a do të kemi rinumërimet të tjera d.m.th. në bazë të parashikimeve tua, punës që e sheh atje?

Burim Ahmetaj: Faleminderit! Raporti nga auditimi nuk është final. Akoma e kemi një numër të vendvotimeve të cilat pritet të procesohen në bazën e të dhënave. Pra, nga formularët e rezultateve për subjekte FPR-ë janë diku 87.11% të vendvotimeve të procesuara. Nga listat përfundimtare të votuesve i kemi 91.33% të procesuara deri më tash që janë në rregull dhe e kanë statusin e përfunduar, ndërsa nga formularët e rezultatit të kandidatëve janë 72,32% të proceduara në bazë të dhënave. Mirëpo edhe pse një numër i FPR-ve janë të procesuara në numër shumë më të madh se sa formularët e rezultateve të kandidatëve, formularët e rezultateve të kandidatëve janë ata që

kanë probleme . Patjetër duhet të merret edhe FPR-ja për tu bërë të gjitha krahasimet edhe për ti gjetur të gjitha ato raste . Është shumë e vërtetë që kemi raste ku për shkak të gabimeve njerëzore është bërë bartja prej fletës punës në fletën e formularit të rezultateve origjinale ka pasur shënime të votave të subjekteve jo në vendin e duhur. Pra, ka pasur në vend tjetër apo një subjekt tjetër janë shënuar këto vota.

Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve e ka bërë këputjen, d.m.th. të atyre vendvotimeve që kemi mundur t'i procedojmë dhe, i ka gjetur të gjitha këto vendvotime duke mos përjashtuar edhe rastet ku tejkalohej numri i votave. Dhe, tha z. Ahmetaj, është edhe një numër tjetër i vendvotimeve të cilat pritet për vendimin e KQZ-ës për tu rinumëruar, mirëpo jemi në proces dhe nuk kemi mundur ta sjellim të gjithë sasinë pra, të formularëve të rezultateve. Mirëpo, konsideroj që kjo është një pjesë e raportit nga auditivi dhe pjesa tjetër është pasi të kompletohen të gjitha formularët e rezultateve në bazën e të dhënave. Sa i përket votave me kusht dhe atyre me postë jemi në procesin e regjistrimit të votuesve me kusht dhe pasi të kompletohet skanimi i listës përfundimtare që nuk është i kompletuar dhe pasi të bëhet regjistrimi i të gjithë votuesve nuk është në bazën e të dhënave , atëherë do të bëhet krahasimi dhe do të identifikohen të gjithë ata votues që kanë votuar më shumë se një herë. Nuk mund të them që mund ti përfundojmë brenda ditës, mirëpo besoj që ndoshta me dinamikën që kemi besojmë që nga fillimi i javës veç fillojmë ti bëjmë këto verifikime në mënyrë që ti kemi numërimet e votave me kusht dhe votave me postë.

Valdete Daka: Faleminderit, Burim. Urdhëro!

Adnan Rrustemi: Faleminderit! Në fakt Burimi në shumë prej çështjeve që kisha mi ngritë dha sqarime. Unë inkurajoj që të vazhdoj punën në këtë drejtim me gjithat kam disa çështje të cilat kisha dashur shpjegime të vogla prej Burimit që lidhen më shumë me rekomandimet për kategoritë e veçanta. Megjithatë po e themi që u pa e qartë që nuk janë të gjitha kutit sepse kemi edhe disa raste që janë adresuar edhe janë identifikuar dhe janë bërë edhe ankesa në PZAP-ë kur bëhet fjalë për vendosje të gabueshme të votave për partinë politike në FPR-ë rrjedhimisht janë vendosur votat për kandidat. Dhe, nuk e pash që janë reflektuar në këtë tabelë. Mbase do të jenë raste tjera që do ti kemi sepse siç u tha ka shume raste që përmbajtja e FRK-së e zbardhë ne fakt pasaktësinë e FPR-së. Fakti që kandidatët kanë vota tregon qartë që gabimet janë bë duke mos ju vendos votat partive politike në FPR-ë. Ka edhe raste të kundërta nuk ka dyshim, por ka shumë rendësi që me u përmirësua ky aspekt d.m.th rruga për me e përmirësuar FPR-në është shpesh herë përmes FRK-së. Unë veç desha me u ndal tek rekomandimet që janë, rekomandimi i parë thotë që të rinumërohen votat e kandidateve për atë subjekt politik. Proceduralisht po më intereson qysh bëhet fjalë për hapje të kutisë, bëhet fjalë për proces të ri për komplet vendvotimin për formulë FRP dhe FRK apo ndërkohë aktiviteti është vetëm numërimi i votave të kandidatëve të vetëm atë subjekti politik që ka rrjedhimisht mospërputhje. Vetëm po dua ta di, me ma prezantuar proceduralisht. Qysh realizohet dhe a krijon probleme kështu teknike me i veçuar votat e vetëm një partie politike, mos mi numëruar parit e tjera dhe me u përqendruar vetëm te kandidatët e një subjekti politik? Edhe të tretën për sugjerim, me i shmang këto terminologjitë, ghost, spajdermen, supremen, me përshkuar pak ma zyrtarisht fenomenin...

Burim Ahmetaj: Këto janë për të brendshëm. Ndoshta s`mundemi me ti pasqyrojmë brenda në tabelë, por janë për përdorime të brendshëm, identifikime të brendshëm. Ndoshta do ta marrim parasysh këtë sugjerimin e juaj. Është e vërtetë që në këtë tabelë nuk janë pasqyruar ato kur subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, mirëpo janë një numër i madh dhe jemi në përgatitje të raportit nuk kemi mundur ti sigurojmë, mirëpo i kemi siguruar vetëm rastet kur subjektet, janë vetëm një pjesë nuk janë të gjitha rastet mirëpo i kemi edhe këto rastet kur subjekti i ka zero vota dhe kandidatët kanë. Një pjesë e rasteve kanë që i referohet që rrjedhimisht subjektit nuk i është shënuar vota aty ku duhet. Mirëpo kur vjen pjesa tjetër e raportit dhe besoj se do të përfshihen të

gjitha vendvotimet. Kjo është një pjesë e vendvotimeve, 115 vendvotime. Dhe, kjo pyetje e juaj flitet për rinumërim të pjesërisht të vetëm të subjektit në kemi mëndur që procedurat me u zhvillu të jenë të njëjta mirëpo fokusi do të jetë vetëm te ai subjekt ku edhe është dallimi. Mirëpo në fund të fundit KQZ-ja vendos se si, a do të bëhet rinumërim të plotë apo ndoshta vetëm pjesërisht. Procedura do të jetë e njëjtë mirëpo vetëm një subjekt do të rinumërohet.

Adnan Rrustemi: Më falë, a mundem? A ju krijon problem se mundet prapë me nxjerr prapë mos përputhje, qysh është zhvillu në të kaluarën? D.m.th bëhet fjalë për veçim të partive që nuk kanë probleme përqendrohen te një parti që nuk kanë përputhje.

Burim Ahmetaj: Kur të hapet kutia ndoshta problemi, problemin e nxjerr.

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare! Edhe unë e inkurajoj, e përgëzoj për punën e deritanishme që ka bërë qendra e numërimit dhe Burimin veçanërisht sepse e di sa herë që kam shkuar e kam gjetur aty duke punuar. Unë isha mbrëmë edhe normalisht edhe subjekti im ka gjetur vende ku janë bërë gabime njerëzore edhe janë bartur votat prej subjektit tonë te një subjekt tjetër që besoj edhe te subjektet tjera dhe votat e kandidatëve janë. Në bashkë me Burimin shikua. Pash që një ishte përmirësuar, një po e shoh këtu edhe katër tjera nuk janë. Besoj që janë në pjesën tjetër se unë jam drejtuar me shkrim i kam dorëzuar edhe formularët edhe ju kam dorëzuar me email. Të gjitha këto mospërputhje që janë unë besoj që në fund të procesit do të rregullohen. Faleminderit!

Betim Gjoshi: Kryetare, duke e parë që kësaj here nuk kemi edhe raste shumë, jemi brenda dinamikës së parashikuar. Ndoshta ka qenë mirë këtë kategorinë e parë me marr vendim që ti rinumërojmë të gjitha edhe për një arsye tjetër që me pa prapë edhe te kjo kategori analizën e këtyre votave të pavlefshme. Ndoshta ka qenë mirë që Komisioni Qendror Zgjedhor edhe pse ju nxjerrim pak më shumë punë ,por për ta garantuar edhe publikun edhe kandidatët që ne po mundohemi që çdo votë ta dërgojmë në vendin e vet sipas vullnetit të votueseve ka qenë mirë me i rinumëruar. Nuk janë shume kuti. Mendoj që mundemi brenda dy ditëve me i përkundu, kështu që ka qenë më mirë me i rinumëruar.

Valdete Daka: Faleminderit, Betim! Mirëpo na e kemi marr përafërsisht një zotim, se brenda ditës 60 kuti rinumërohen, brenda një ndërrimi, kjo i bëjnë që këto kuti të gjitha rinumërohen, dhe natyrisht që për ne sa ma të sakta të jenë rezultatet.

Betim Gjoshi: Edhe ndoshta është mirë, dhe pse sot është ore 11:30, në mundemi me i vonuar me vendime. Në qoftes e kanë për nesër është mirë me na lajmërua ma herët, na prapë nesër këtu jemi. Për tjerat që mos me ju pengu juve në dinamik, kurdo që keni, të gatshëm jemi.

Valdete Daka: Po atë doja ta thosha, që kishte qenë mirë që na të punojmë paralelisht. Mos të presim te rinumërohen këto e të marrim raportin tjetër, po në ndërkohë edhe gjatë ditës të nesërme të na sjell raportin nëse ka kuti tjera, që sigurisht do të ketë që të marrin vendim që mos të ndërprehet procesi i rinumërimit fare. Atëherë në qoftes nuk kemi pyetje të tjera po vazhdojmë me kategoritë ashtu qysh siç na janë propozuar.

Burim Ahmetaj: Tash me qenë se Betimi tha që tash varet KQZ-ja qoftë se edhe për një votë mu rinumëruar të plotë atëherë kategoria e parë që është 1A dhe 1B që duhet me kanë rinumërimi i plotë. Nuk ka dallime se këtu ka qenë rekomandimi që deri në 10 vota të bëhen të pjesërisht e mbi 10 vota diferencë mu bë i plotë. Tash varet nga KQZ-ja.

Adnan Rrustemi: Jo unë kërkova sqarim për këtë qëllim në fillim sa është e mundur numërimi i pjesërisht. Nëse ju e konsideroni që është e mundur numërimi i pjesërisht nuk kemi pse me bo rinumërim të përgjithshëm të kutisë për me kursye edhe kohë e me i procedua ma shpejtë. Prandaj pyeta që në fillim

Valdete Daka: Kategorija e parë A1A mos përputhja e votave të kandidatëve të një subjekti ku diferenca nuk kalon mbi 10 vota dhe është rekomanduar që të rinumërohen vetëm votat e kandidatëve për atë subjekt.

Binak Visha: Tejkalimi është i vogël deri në 1 votë deri në 10 vota. Nëse Burimi e garanton që mundet mu bo numërim i pjesshëm përveç këto që rekomandon normal që shkon ma shpejtë në rast se detyrohem me bërë rinumërim të plotë atëherë duhet me pa me korrigjuar se është gjithçka në kuadër të procedurave të numërimit sikurse është për numërimin e rregullt në vendvotim

Valdete Daka: Mesa e kuptova Burimin, ai tha që në vendvotim kur hapet kutia mundet me ndodh që del edhe ndonjë problem tjetër. Po urdhëro Ercan!

Erxhan Spat: Po unë mendoj që pse mos ta provojmë propozimin e zotëri Betimit. Nuk po na vonon asgjë. Dy dit e kemi në pyetje. Duhet ta kemi parasysh një element shumë të rëndësishëm janë kandidatët të cilët për dy vota nuk bëhen apo bëhen deputet. Sepse është dallimi dhjetë mijë apo me disa qindra vota bëhen, disa subjekteve tjera.

Eshref Vishi: A ke informacione të sakta se sa është numri i këtyre rasteve që kërkohet, p.sh, që janë subjektet pjesërisht të hapet kutia.

Burim Ahmetaj: Është një numër i madh i vendvotimeve, por sidoqoftë Qendra e Numërimit është e gatshme për cilindo opsion që vendos KQZ-ja. Ne jemi të gatshëm.

Eshref Vishi: Kisha propozuar që le të lëviz me propozimet e veta. D.m.th kërkesat që ka në raport pjesërisht, e mos të dalin probleme se ne jemi këtu edhe brenda ditës edhe nesër.

Adnan Rrustemi: Ti kthejmë nuk ka nevojë, por ne në parim mundemi ti miratojmë rekomandimet QNR-së. Dhe, në rastet kur QNR-ja edhe par kategorinë e parë e sheh që ka nevojë për numërim të plotë, e bën numërimin e plotë ndërkohë na njofton që ka ndodhur procesi i numërimit të tërësishëm.

Burim Ahmetaj: Është e vërtetë që rekomandimi ka qenë i fokusuar vetëm aty prej auditimit ku janë gjetur, ato të gjetura, mirëpo nuk e dimë çfarë ka brenda kutisë si është gjithë materiali i selektuar brenda kutisë. Kështu që thash kur hapet kutia e nxjerr problemi problemin, pastaj ndoshta detyrohem një pjesë të madhe të vendvotimit do të bëhet i plotë rinumërimi. Kështu që ndoshta është më mirë me shkuar me vendim.

Valdete Daka: Aty ku gjatë numërimit del që duhet të rinumërohet të rinumërohen të gjitha?

Sami Hamiti: 90% ka me iu dashtë me i rinumëruar, kështu që të shkojmë në rinumërim të plotë.

Valdete Daka: Ne po ia japim atë leje. Kemi propozimin që, nëse, kur hapet kutia del me probleme, atëherë të rinumërohet.

Sami Hamiti: Betimi e ka dhënë një propozim, të rinumërohen të gjitha.

Valdete Daka: Kush është që të rinumërohen të gjitha. Kategorija e parë. Le të rinumërohen. Kategorija e dytë? Kush është që kategorija e dytë, tretë, katërt të rinumërohen, që mos të zgjasim më tutje? Faleminderit! E kemi edhe një raport të Burimit. Urdhëro, Burim!

Komisioni miratoi propozimin që të rinumërohen të gjitha kategoritë.

Betim Gjoshi: Ndoshta është mirë me tregu që 115 kuti vendosem me i rinumëruar. Edhe për subjekte edhe për kandidat.

Burim Ahmetaj: Faleminderit, kryetare! QNR gjatë rinumërimit të 30 vendvotimeve të cilat kanë qenë si rezultat i pranimit, që kanë qenë në karantinë. Ka bërë edhe një punë tjetër, që ka bërë edhe një analizë preliminare të fletëvotimeve të pavlefshme të atyre 30 vendvotimeve. Raportin e keni para vetës dhe këto janë të gjeturat nga analiza preliminare. Kjo nuk do të thotë që është analizë përfundimtare, mirëpo janë marrë ato vendvotime të cilat kanë qenë objekt i rinumërimit. Dhe nga kjo analizë, nga ky hetim rezulton se janë vetëm 3 kategori të cilat dominojnë te numri i madh i fletëvotimeve. Pra nga 30 vendvotime janë 518 fletëvotime të pavlefshme. I keni të listuara sipas vendvotimeve dhe sipas komunave. Dhe, kategoritë e pavlefshme janë, kur e ka shënuar më shumë se një subjekt, që është një pjesë dominonte. Kategoria tjetër e ka shënuar vetëm kandidatin, mirëpo nuk e ka shënuar subjektin. Kategoria tjetër, është dëmtim i qëllimshëm.

Nga hetimi, tha Ahmetaj rezulton se kategoria kur është shënuar më shumë se 1 subjekt dhe kur janë shënuar kandidatët dhe nuk është shënuar subjektin, janë kategori dominante. Kategoria dëmtim i qëllimshëm është në numër shumë më të vogël. E kemi vetëm një vendvotim kur është e pavulosur, por ndoshta nuk ka ndonjë pjesë të madhe. Këto janë të gjeturat nga hetimi i kësaj analize preliminare të këtyre fletëvotimeve të pavlefshme të këtyre 30 vendvotimeve.

Betim Gjoshi: Faleminderit shumë! Për mu është interesant analiza. Është e dallueshme prej analizës së mëhershme që kemi bërë. Por nuk është krejt e papritur. Çka më kish interesuar si anëtarë i KQZ-së, është sa raste ka pasur që ish dashtë me qenë të vlefshme e janë shpallë të pavlefshme. Kjo ka qenë me rëndësi si rubrikë. Për tjera herë kur ta realizoni, nuk po e kërkoj kësaj here. Në këtë rast, ne po shohim, nga këto që janë hetuar në këto 30 kuti, 50% saktë janë që kanë votuar kandidatët e jo edhe subjektin. Që është mungesë e edukimit nga ne dhe nga subjektet politike, ose edhe presionit të madh të kandidatëve me shumë se të partive politike. E dyta, rreth 40% është kategoria që është votuar më shumë se 1 subjekt. Edhe kjo mund të jetë dëshirë e votuesve që të votojnë më shumë se 1 subjekt, por mund të jetë edhe rezultat i mos informim të duhur. E treta, dëmtimi i qëllimshëm, apo njëfarë revolte e votuesve që shkon deri në 11%, që nuk i kanë pasur të përzgjedhurit e vet në atë listë, dhe kanë dalur e kanë treguar votën e vet, por nuk e kanë shprehur qëllimin për të votuar për dikë. Të dy mbi 90% e kategorive shkojnë si mungesë e edukimit, pavarësisht a është rezultat i yni apo jo. E kam pritë gati kështu, vetëm e kam pritë këtë kategorinë e parë që do të jetë edhe më e madhe, që kanë votuar për subjekte. Edhe pse, mbi 10 vite ka që e kemi të njëjtin proces zgjedhorë. Është befasuese si. Sepse nuk ka rrjedhë edukimi vetëm prej sotit, sepse nuk ka ndryshuar në proces asgjë që nga 2007. Këtë kemi kaq kategori, është e pashpjegueshme kaq shumë. Por, mbetet që ne me punuar më tutje që me eliminuar këtë kategori, sepse i kalon edhe historikun e zgjedhjeve në Kosovë, sidomos zgjedhjeve nacionale, por edhe mendoj standardet mesatare, ku kemi rreth 8% apo 9% të fletëvotimeve të pavlefshme në nivel vendi.

Adnan Rrustemi: Në fakt, falënderoj QNR-në që na ka sjellë këtë informacion! Megjithëse e konsideroj të pjesshëm. Nuk mendoj që është reprezentativ ky për krejt kategoritë e as për krejt shkaqet. As nuk mendoj që duhet ta zëvendësoj një hetim që duhet ta bëj KQZ-ja pas përmbylljes së procesit zgjedhorë. Të ngjashëm me një analizë që është bërë pas zgjedhjeve të kaluara. Ku shprehë ose identifikon kategoritë e sakta. Nga ato që kanë qenë rezultat i mungesës së informimit dhe edukimit të votuesve deri te rastet që mund të jenë të shpallura si fletëvotime të pavlefshme, si rezultat i mungesës së trajnimit të mjaftueshëm për KKZ-në. Për raste specifike, siç e dimë. Dhe, edhe këto raste që po prezantohen si dëmtim i qëllimshëm, apo si shprehje e një lloji pakënaqësie. Unë mendoj që nuk duhet të përqendrohemi në këtë fazë. Mirë është me i mbledhë ju këto informacione në secilën kuti që ka rinumërim, por këto do të jenë mbledhje e të dhënave që do t'i shërbejnë një komisioni që do ta hetoj më pas komplet këtë çështje. E kemi të pamundur kështu me bë vlerësimin dhe diskutimin kuti për kuti, e raste për raste. Duhet ta përcaktojmë një mostër që e përfshinë gjithë vendin, që merr specifikat e caktuara urbane, rurale. Duhet ta dimë a është më i

theksuar në vendbanime urbane apo rurale. Që ta dimë pastaj ku ta orientojmë edhe, në procese të ardhshme edukimin e votuesve. Edhe zona tjera dhe kritere tjera këto informacione mblidheni për me i shqyrtuar në një moment tjetër dhe për me i shërbyer në një moment tjetër. Sa i përket veprimeve që mund të ndërmarrim si KQZ, natyrisht që duhet së shpejti ta vlerësojmë se çka mund të bëjmë në këtë drejtim. Sidomos për zgjedhje lokale, ku siç e dimë numri i fletëvotimeve të pavlefshme është dukshëm më i lartë. Edhe për shkak të specifikave të sistemit zgjedhor për zgjedhje lokale. Por, është brengosëse rritja e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme, përkundër që nuk ka ndërruar sistemi.

Betim Gjoshi: Unë, kryetare kam mendim pak më ndryshe. Unë mendoj që në këtë fazë duhet të vazhdojmë edhe për një qëllim të vetëm se kemi shumë fletëvotime që janë shpallur të pavlefshme, janë të vlefshme ne duhet ti rinumërojmë të gjitha kutit sepse rezultati është i ngushtë nuk kemi ndonjë rezultat të gjanë. Mendoj se jemi para certifikimit na hyn në punë për këtë arsye, nuk munden me na hy në punë pas certifikimit ne mundemi me pasur gjasa ti numërojmë krejt qoftes kemi një përqindje prej tyre të pa vlefshme, kanë qenë 20% të pa vlefshme kanë qenë, për këtë na nevojitet statistika e para. E dyta për ta marr, me nxjerr mësim nga këto për zgjedhjet lokale sepse i kemi në prag zgjedhjet lokale për ti implementuar edhe për atë arsye na nevojitet. Nuk po them që këta ta humbin gjithë kohën me to, por këto ishin kuti që i kanë nxjerr problem në analizat e mëtutjeshme nuk i pengon askush ato kanë vazhduar në të kaluarën pa i penguar askush, por përnjëmend është rritje e madhe. Një prej rritjeve mund të jetë këta munden ta nxjerrin këto libra të votimit sa ka pasur asistencë se i kemi bërë një presion ta largojmë asistencën, ne e dimë që kemi mijëra njerëz analfabet në vend, kemi edhe mijëra njerëz që nuk janë të kapshëm për këtë situatë sepse sistemi është goxha i vështirë edhe për vendet me demokraci të lartë zgjedhore, por ne është mirë me pasur një analizë por me pasur me këtë kategori siç e kemi pasur edhe në herën e kaluar mos me ngushtuar në tri kategori, është mirë ta kemi me krejt. Nuk po them që e kemi marr ndonjë vendim bazë tyre por është mirë ta kemi.

Binak Vishaj: Kryetare, është mirë ta kemi një pasqyre për 30 vendvotime të cilat KQZ-ja ka vendosur ti rinumëroj. Konsideroj se është mjaftueshëm numër shqetësues 10% që është votat që është dashur të jenë të vlefshme, janë të pa vlefshme. Unë kisha thënë që QNR-ja të vazhdoj që të gjitha kutit që është duke i rinumëruar ti merr edhe votat të cilat janë të pa vlefshme, sa është ky numër në rritje edhe pajtohem në rast se ky numër është një numër i madh por KQZ-ja do të duhet të ketë një vendim se cili do të jetë veprimi në të ardhmen sepse një dështim ka ndodhur, dështimi në trajnim ka ndodhur këto janë fletëvotime të vlefshme kur votohet subjekti politik edhe nuk votohen kandidatët është fletëvotim i vlefshëm. Pse është futur si fletëvotim i pavlefshëm edhe këtë përgjegjësi duhet me marr.

Adnan Rrustemi: Jo. Këtu nuk ka asnjë rast të fletëvotim të vlefshëm të shpallur si të pavlefshëm. Madje se bëhet fjalë për raste ku janë votuar për më shumë se dy subjekte politike dhe janë rastet ku janë votuar vetëm kandidatët dhe nuk janë votuar subjekti politik që janë të pastra të pavlefshme. Sa për informacion rastet që po rinumërohen, po rinumërohen që nga fillimi edhe fletëvotimet e pa vlefshme, unë e kam përcjellë nga afër. Çështja është me na treguar nga këto rinumërimet. Tash unë e di që kërkon kapacitete pak për QNR-në, por ju po i publikoni FPR-të dhe FRK-të. Mund me u bë krahassime se a ka lëvizur edhe numri i fletëvotimeve të pavlefshme. Unë sa kam pa nuk ka pasur raste kur ndonjë fletëvotim i vlefshëm është shpallur i pavlefshëm. Unë nuk e përjashtoj këtë mundësi, e di që komisionerët kanë mundur me bërë edhe këso gabime. Ju rinumërimet që i bëni, i bëni nga fillimi, duke përfshirë edhe fletëvotimet e pavlefshme. Duke i vlerësuar edhe një herë ato, edhe ato që janë të vlefshme i shndërroni në të vlefshme. S`ka asnjë dyshim. Por, çështja është që, për nevoja të vlerësimit të kësaj problematike nuk mund të bëhet me të dhëna të tilla të selektuesit. Duhet një analizë sa sociologjike, me elemente të etnografisë, të edukimit me e parë gjendjen në përgjithësi, për me e nxjerrë rekomandime të qëndrueshme.

Burim Ahmetaj: Është shumë e vërtete se vendvotimet të cilat kanë numër më të madhtë fletëvotimeve të pavlefshme janë kryesisht ato që rinumërohen. Këto të gjitha janë të qëllimshme. Asnjë nuk është marrë si mostër e caktuar, mirëpo të gjitha janë marrë nga vendvotime që janë rinumëruar. Është shumë e vërtete që ka qenë një fletëvotim i pavlefshëm që faktikisht ka qenë i vlefshëm dhe e kemi kategorizuar si fletëvotim të vlefshëm. Mirëpo është i pasqyruar këtu, sepse nuk kemi pas objekt hetimi atë fletëvotim. Kjo është vetëm preliminarja, por pasqyrë se pse kanë mundur me ndodhë kaq numër i madh i fletëvotimeve të pavlefshme. Nuk ka pasur ndonjë qëllim tjetër kjo analizë. Vetëm me parë qëllimin e pavlefshmërisë së këtyre fletëvotimeve dhe me krahasuar se çka ka mundur deri të pavlefshmëria e tyre.

Betim Gjoshi: Ne po kërkojmë me vazhduar më tutje me na dhënë vlerësimin, dhe me i zgjeruar kategoritë ashtu siç i kemi pasur në të kaluarën. Dhe, nuk tha askush që ne do të dalim me një rekomandim, sepse rekomandimet i kemi edhe vështirë me i nxjerrë, edhe pse është ardhur deri te ajo. Mundet me qenë edhe subjektive. Por, ne është mirë me ditë pasqyrën, cilat kategori dhe nga sa % i kemi. Kategoritë po ndryshojnë. Përpara 12-13% i kemi pasur kategorinë që janë votuar dy subjekte, tash është rritë 50%, ose 40%. Kjo është ajo, pasqyrën që e shohim. Analizën, rekomandimet, ka shërbime profesionale brenda institucionit që ish dashtë me nxjerrë dhe që e nxjerrin. Ka kohë edhe më tutje, por për këtë fillim është mirë me e pasur një pasqyrë të saktë, cila është kategoria. I kemi 3, shikoni edhe tjerat. Munden me qenë edhe tjera. Një prej tyre që ka mundur me pas të vlefshme, është shpallë e pavlefshme. Kjo është me rëndësi. Nëse nuk kemi këso kategori, atëherë është mirë për ne, sepse kjo problematika është për analizë më tutje. Po e dimë e kemi në nivel vendi 8% të pavlefshme. Këtë s`mund ta fshehim. Edhe është më e madhe se çdo herë, bile e tejkalon më shumë se dyfishin e çdo palë zgjedhje nacionale që kemi pasur. Është shqetësuese, por duhet me analizuar pse jemi ardhur deri këtu.

Valdete Daka: Faleminderit!

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
